

1 E enjte, 13 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutem paraqisni çështjen.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, kjo është

8 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim

9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04746. Vërej

12 për procesverbal, që z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z.

13 Krasniqi janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

14 Përpara se të thërrasim dëshmitarin, ju kujtoj sikurse

15 është komunikuar më herët sot nuk do të kemi seancë të tretë,

16 Prandaj seanca do të mbyllet në orën 1.00 të drekës. Dhe do të

17 rifillojmë nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

18 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin.

19 Znj. Prokurore, ka ndonjë ndryshim sa i takon

20 përllogaritjes kohore?

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mendoj se do të përfundoj sot.

22 Mendoj se do të përfundoj sot. Mendoj se do më nevojitet e

23 gjithë seanca e parë, mbase dhe pak më shumë, por sidoqoftë do

24 të përfundoj sot.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 2

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
2 uleni.

3 Dëshmitar, mirëmëngjes. Do të vazhdojmë sot me dëshminë  
4 tuaj. Faleminderit që erdhët. Ju lutem përgjigjuni pyetjeve  
5 qartë me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni një  
6 pyetje, lirisht kërkoni që personi që po ju pyet ta përsërisë  
7 pyetjen ose thoni që nuk e kuptoni dhe do ta sqarojnë.

8 Gjithashtu, na thoni ku e mbështesni njohurinë tuaj për  
9 faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

10 Dua t'ju rikujtoj se jeni ende nën detyrim për të thënë  
11 të vërtetën sikurse vetë e deklaruat përmes deklaratës  
12 solemne.

13 Mos harroni të flisni para mikrofonit, prisni pesë  
14 sekonda para se t'i përgjigjeni një pyetjeje dhe flisni  
15 ngadalë edhe për përkthyesit.

16 Nëse keni nevojë për pushime, na njoftoni dhe ne do të  
17 plotësojmë këtë nevojë.

18 Të rifillojmë me pyetjet e drejtpërdrejta nga Prokuroria.

19 Prokurore, fjala është për ju.

20 DËSHMITARI: W04746 [Vijon]

21 Pyetje nga Znj. Lawson: [Përkthim] [Vazhdim]

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

23 PY. Mirëmëngjes, z. Mustafa. Dje keni përmendët disa herë  
24 Adem Demaçin në dëshminë tuaj. Çfarë ishte pozicioni i tij  
25 zyrtar pranë UÇK-së?

1 PË. Ai ishte drejtor i drejtorisë politike për Ushtrinë  
2 Çlirimtare të Kosovës. Por mbi të gjithë, ishte lideri i  
3 shqiptarëve për vite me radhë që ishim në okupim nën Serbi.

4 PY. E keni fjalën për drejtorinë e përgjithshme politike të  
5 UÇK-së apo ndonjë zyrë politike tjetër më e vogël mbase?

6 PË. Për mua, ai ishte drejtorja më e madhe politike për UÇK-  
7 në.

8 PY. Pra, mesa kuptoj unë, kjo ishte më e rëndësishmja por  
9 cila ishte më e rëndësishmja?

10 PË. Për mua ajo ishte më e rëndësishmja, zyra që udhëhiqej  
11 nga Adem Demaçi në Prishtinë.

12 PY. Pra, ka qenë drejtorja politike e UÇK-së në Prishtinë të  
13 cilën drejtonte z. Adem Demaçi, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Na thatë që është dikush shumë i rëndësishëm për ju. E  
16 njihnit mirë?

17 PË. Po, e njihja mirë.

18 PY. Qartazi ka pasur ndikim sa u takon aspekteve politike për  
19 ju, apo jo?

20 PË. Po, në përgjithësi unë kam qenë kooperativ shumë me  
21 mësuesin Demaçi.

22 PY. E keni fjalën më shumë për ju, personalisht, apo dhe  
23 anëtarët e tjerë të UÇK-së?

24 PË. Ai ka qenë në përgjithësi për popullin shqiptar dhe për  
25 gjithë UÇK-në, po për mua ishte, e pranoj se ka qenë edhe më i

1 veçantë.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja  
3 të kalonim shkurtimisht në seancë private për disa pyetje të  
4 cilat lidhen me një person konkret.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
6 çaktivizuar]. Kalojmë në seancë private.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 5

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Znj. Lawson, mund të vazhdoni.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit. A mund të nxjerrim

18 dokumentin SITF00243091 dhe anglishtja e njëjta gjë po mbaron

19 me ET në fund. E kemi parë edhe dje. Do ju lutesha ta nxjerrim

20 shkurtimisht prapë në ekran, por nuk është për t'u transmetuar

21 për publikun. Mund të shkojmë në faqen 243132 për të dyja

22 versionet shqipe dhe anglishte.

23 PY. Z. Mustafa, a mund të shihni shënimin 14 dhe 15, rreshtin

24 14 dhe 15. Pas kolonës që thotë:

25 "...ka qenë i angazhuar në U/55".

1 Çfarë do të thotë kjo U/55?

2 PË. Ulpiana 55.

3 PY. Faleminderit.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

5 PY. Dje kur po diskutonim ku, deri në ç'shkallë raportonte

6 Nazif Mehmeti apo jepte informacion lidhur me të ndaluarit

7 shtabit të zonave, ju thatë që ndodhte shumë rrallë.

8 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe kjo është thënë në Pjesën

9 T5573 deri në 74. Dua t'i referohem një nga deklaratave tuaj  
10 atë mëparshme, me lejen e Trupit Gjykues.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Miratohet.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ka qenë para gjykimit të 2003 dhe  
13 referenca për atë është SPOE00119323 dhe 119331, kjo është  
14 anglishtja. Ndërsa shqipja SPOE00119334 në 9343. Do ju lexoj  
15 një fragment të këtij materiali:

16 "Informohesha për të ndaluarit, po nuk isha gjithmonë i  
17 informuar gjithmonë për të gjitha. Kishte persona që e kishin  
18 për detyrë ta bënë këtë. Raportet në të gjitha njësitet u  
19 dërgoheshin shefit të shtabit. Mund të kishte ndodhur  
20 ndonjëherë që të kishte 1, 2, 3 të ndaluar që i sillnin dhe po  
21 unë nuk ndodhesha aty. Unë kërkoja dhe kam marrë raport direkt  
22 nga Nazif Mehmeti. Ai kishte për detyrë të raportonte tek  
23 shtabi për ndonjë ndryshim të vogël. Besoj se ka pasur  
24 udhëzime me shkrim në lidhje me këtë".

25 Kështu është, e kishte për detyrë t'i raportonte shtabit



1 për ndonjë ndryshim?

2 PË. Znj. Prokurore, interesimi juaj i pyetjeve të shpeshta po  
3 edhe atëherë edhe nga Prokuroria dhe nga të gjithsekush po bën  
4 sikur po ekzagjerojmë këtë temë. Nuk ka qenë kaq e rëndësishme  
5 sapo duam ta bëjmë. Megjithatë, ekzistoj pas gjithë asaj që  
6 kam thënë gjithë. Duke insistue me pyetje të njëjtë përherë,  
7 po ekzagjeronen këto sikur rasti me dokumentet administrative  
8 dhe që për mua s'ishin të njohura, por unë s'kam pse të mos i  
9 pranojë ato. E pranoj në tërësi çka kam thënë në këto.

10 PY. Faleminderit. Pra, me sa kuptoj çështja e ndalimit po  
11 ekzagjerohet, por që ju e pranoni informacionin që ë thënë në  
12 deklaratën që unë sapo jua lexova, kështu?

13 PË. Unë e pranoj që Nazir Mehmeti ka qenë i përgjegjshëm dhe  
14 ka kryer punën me nder dhe është marrë me çështjen e të  
15 ndaluarve dhe është kujdes për ta. Sa herë ka pasë nevojë ai  
16 ka ardhë dhe më ka njoftue mua apo shtabin e zonës operative  
17 të Llapit për punë që si që bëheshin aty.

18 PY. Dhe në fakt e kishte për detyrë ta bënte apo jo?

19 PË. Sigurisht.

20 PY. A erdhën ndonjëherë të afërmit në shtabin e Llapit për të  
21 gjetur, për të kërkuar trupat e të afërmeve të tyre që kishin  
22 qenë dikur të ndaluar atje? Në komandën e zonës së Llapit - më  
23 falni?

24 PË. Mu nuk më kujtohen specifikisht, por ata kanë qenë të  
25 lejuar t'i vizitojnë të afërmit e tyre.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 10

1 PY. Do ndryshoj temë. Dje, folëm për vizitat nga anëtarët e  
2 Shtabit të Përgjithshëm në zonën e Llapit në gjysmën e dytë të  
3 1998, më konkretisht në tetor, për këtë lidhet pyetja ime. Unë  
4 ju thashë se që ka qenë një dokument që doja t'ju tregoja për  
5 të cilin duhet të flisnim serish dhe këtë do të bëjmë për një  
6 çast.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Prandaj do i kërkoja që të  
8 nxirrnim librin e z. Zhitia me SPOE00055678, faqja 55838.  
9 Ndërsa anglishtja është SPOE00055699-ET e Rishikuar, faqja  
10 55838.

11 PY. Këtu flitet për një vizitë më 27 dhe 28 tetor 1998 nga  
12 Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Bislum Zyrapi dhe Ramë Buja. Ju  
13 kujtohet kjo vizitë?

14 PË. Unë e di që ka ndodhë një vizitë, por detajet siç shkruan  
15 në libër nuk jam i sigurtë a janë ashtu. E di që Skënder  
16 Zhitia ka bërë një libër të mirë dhe unë e kam komplimentu për  
17 këtë punë, por detajet thashë nuk muj t'i kujtoj kështu si  
18 është në libër. Por s'kam arsye ta mohoj që është e vërtetë.

19 PY. Kush shkuan në shtabin e ri të sapoformuar të  
20 Llapashticës?

21 PË. Është e vërtetë, znj. Prokurore, që nuk më kujtohet. Kjo  
22 kohë ka qenë kohë e angazhimeve të jashtëzakonshme e secilit  
23 prej nesh dhe nuk më kujtohet. Por evidencat që i ka përdorë  
24 z. Zhitia mundet me kanë të sakta.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Duke pa se dëshmitari thotë që

1 nuk i kujtohet unë dua të përmendim dhe të nxjerrim një  
2 deklaratë të mëhershme, të nderuar Gjykatës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Miratohet.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Referenca Pjesa 5, faqja 10 tek  
5 anglishtja dhe Pjesa 5, faqja 11 në shqip.

6 PY. Po ju lexoj një pasazh shumë të shkurtër:

7 "Në atë datë në fund të tetorit kur ata katërt kur erdhën  
8 në zonë, do të thoshte, që erdhën për të parë shtabin tuaj në  
9 Llapashticë?"

10 Kjo ka qenë pyetja.

11 Ju përgjigjeni:

12 "Po, shtabin që sapo ishte krijuar. Po".

13 Ju ndihmon kjo për rifreskuar kujtesën?

14 PË. Unë e thashë edhe për librin e Skënder Zhitisë që mundet  
15 me kanë e afërt e asisoj, por nuk po më kujtohet saktë. E di  
16 se kanë qenë në vizitë. Detajet s'po mundem me i kujtu.

17 PY. A patën mundësi të takoheshin me të gjithë komandantët e  
18 shtabit tuaj?

19 PË. Nuk besoj që ka pasë kërkesë Shtabi i Përgjithshëm kushdo  
20 që ka qenë me i taku të gjithë komandantët, por ata që kanë  
21 kërkuar, ne ia kemi prezantuar atyre me siguri.

22 PY. Ku hëngri dhe ku fjeti delegacioni?

23 PË. Në shtëpitë ku kemi fjetë edhe ne vetë me siguri.

24 PY. Pra, në të njëjtin objekt që përdornit ju në Llapashticë,  
25 kështu?

1 PË. Nuk jam i sigurtë për të njëjtin objekt, por aty dikund  
2 ndonjë shtëpi fshati. Ju mund t'i përdorni edhe deklaratimet e  
3 mia më herët që i kam pasë. Qëndroj prapa tyre, nuk kam arsye  
4 me fshehë asgjë nga vizita e eprorëve të Shtabit të  
5 Përgjithshëm.

6 PY. Po.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të doja po ashtu që të nxirrja  
8 sërish një deklaratë të mëhershme për të lexuar një fragment  
9 të shkurtër.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është Pjesa 5, faqja 17 në  
12 anglisht dhe Pjesa 5, faqja 19 në shqip.

13 PY. Pyetja që u kanë bërë:

14 "Në rregull. I prezantove me komandantët e lartë?"

15 Je përgjigjur:

16 "Po"

17 "PY. Për shembull, Latif Gashi?"

18 "PË. Po. Gjithë shtabi përfshirë dhe komandantët e  
19 brigadave patën mundësinë të takoheshin me ta dhe të bisedonin  
20 me ta. Nuk mund të them konkretisht, po më duket se të gjithë  
21 i takuan sepse patën mundësi që t'i takonin sepse hanin në të  
22 njëjtin vend ku hanim edhe ne".

23 Ju kujton gjë kjo?

24 PË. Nuk shoh ndonjë ndryshim prej asaj që thashë. Nuk muj të  
25 kujtohem në detaje, por kanë mujt me u taku me këndo. E

1 anëtarët e shtabit sigurisht që janë takuar të gjithë ata  
2 ishin me mua. Anëtarët e shtabit e kam fjalën.

3 PY. Çfarë u diskutua në takimet që patët me ata në atë  
4 vizitë?

5 PË. Organizimi i përgjithshëm i luftës dhe avancimi sa më  
6 shumë që mundeshim. Tash ishte koha e bashkëpunimet me  
7 organizata të shumta ndërkombëtare dhe mundësia që të  
8 avanconim sa më shumë në qëllimin tonë.

9 PY. Në diskutime u përfshinë edhe çështje politike dhe  
10 luftarake?

11 PË. Çështje e njësiteve, përgatitja e tyre dhe çështjet  
12 normalisht edhe politike.

13 PY. Ju dhanë udhëzime për ndonjë gjë të veçantë gjatë asaj  
14 vizite?

15 PË. Ndonjë ka pasë. Me siguri ka pasë udhëzime dhe ne i kemi  
16 dhënë dhe ata kanë dhënë. Po nuk më kujtohet që ka pasë diçka  
17 të veçantë. Të përgjithshme rreth luftës dhe mbarëvajtjes së  
18 luftës. Kemi fol për shumë tema.

19 PY. Po strukturat e administratës civile a diskutuat?

20 PË. Ka qenë e mundshme që edhe ato edhe për to kemi fol, për  
21 me u mundu me i shtri në të gjithë vendin organizimin e  
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës përmes drejtorisë së  
23 organizimit civil.

24 PY. Dhe gjatë asaj vizite u zgjodhën njerëz të caktuar për  
25 t'u përgjigjur për çështje të administratës civile?

1 PË. Gjatë vizite nuk besoj se janë zgjedhë, po pastaj ne kemi  
2 mujt me i caktu njerëz të cilët nuk e kanë përfundu punën  
3 asnjëherë besoj sepse lufta, ofensiva nuk kanë lejuar që të  
4 merren dhe shumë me atë punë.

5 PY. Më pas këta njerëz a i morën këto pozita pas lufte?

6 PË. Ka nga ata që po.

7 PY. Çfarë pozitash morën?

8 PË. Kryetarë komunash.

9 PY. Pra, kryetarë komunash, këtë po thoni?

10 PË. Po.

11 PY. Afërsisht kur i morën këto funksione përsipër?

12 PË. Kur ka përfunduar lufta.

13 PY. Mund të më jepni një datë të përafërt se kur ka ndodhur?

14 PË. Menjëherë pasi ka ardhë KFOR-i, në bashkëpunim me ta,  
15 administrata dhe KFOR-i bashkë na u ka lut të caktojmë  
16 përgjegjës për komuna dhe ne i kemi bërë. Atëherë ka qenë e  
17 formume dhe Qeveria e Përkohshme, tash po më kujtohet dhe në  
18 bashkëpunim të gjithë njerëzit i kanë emëru kryetarët e  
19 komunave për Prishtinë dhe Podujevë. Ndikim kanë pasë unë dhe  
20 ata njerëz që kam propozue ata, ata janë bërë kryetarë.

21 PY. Dhe ata ishin pjesë e strukturës së Qeverisë së  
22 Përkohshme?

23 PË. Për besë nuk po më kujtohet organogrami tani. Por unë e  
24 di se ata kanë kenë për pesë ose gjashtë muaj kryetarë  
25 komunash që ne i kemi caktuar në bashkëpunim me të gjithë

1 faktorët relevant të asaj kohe.

2 PY. Pra, i bie të ketë qenë qershori i 1998. Pra, gjatë  
3 vizitës që u bëri Shtabi i Përgjithshëm ata ju dhanë udhëzime  
4 për zgjedhjen e këtyre njerëzve dhe për një ide sesi do të  
5 drejtonin komunat pas lufte apo dhe gjatë luftës, kështu?

6 PË. Znj. Prokurore, ne kemi fol për gjatë luftës që të kemi  
7 shtrirje sa më të mirë. Nuk besoj as Shtabi i Përgjithshëm dhe  
8 as ne që e kemi mendu qershorin, që kemi mund aq shpejt të  
9 lirohemi. Nuk kemi fol për temat pas luftës. Por unë meqë i  
10 kisha dha, u kisha jep detyra njerëzve gjatë luftës unë kam  
11 pasë respekt për ta dhe jam përpjekë që ata të mos lihen anash  
12 po të përfshihen në organizim civil dhe politik mbas luftës.

13 PY. Në atë kohë ishte shpall armëpushimi, kështu?

14 PË. Po.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua që t'i tregoj një pjesë të  
16 shkurtër të një deklaratë të mëparshme dëshmitarit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është Pjesa 5, faqja 15 në  
19 anglisht dhe Pjesa 5, faqja 16 në shqip.

20 PY. Ju thatë që:

21 "Të njëjtët njerëz që caktuam u bënë kryetarë komunash  
22 pas lufte. Mendoj që kjo ishte arsyeja që Shtabi i  
23 Përgjithshëm erdhi të na vizitonte në atë kohë për të na  
24 udhëzuar sesi t'i përzgjidhnim njerëzit dhe për të pasur një  
25 ide sesi të drejtonim, të qeverisnim komunat gjatë luftës dhe

1 pas lufte".

2 E pranoni këtë që keni thënë këtu, z. Mustafa?

3 PË. Znj. Kryetare, kjo ka ndodhë dhe ashtu qysh kam thënë  
4 është. Po nuk ka qenë me ndikim për ndodhë kjo tek zona  
5 operative që unë kam drejtuar, Shtabi i Përgjithshëm nuk ka  
6 qenë me aq ndikim sa tash ne e bëjmë. Mirëpo kemi diskutu për  
7 mundësi të organizimit sa më të mirë të civilëve publik dhe ka  
8 pasë një udhëzim. Individë, emnat të cilët do të vendosen nuk  
9 besoj që i kanë ditë Shtabi i Përgjithshëm në atë kohë po as  
10 më vonë derisa jemi lurue, çlirue që kanë fillu me qenë  
11 kryetarë komunash.

12 PY. Gjatë kësaj vizite të anëtarëve të Shtabit të  
13 Përgjithshëm pati çështje që dëshiroje t'i ngrije me ta?

14 PË. Po ka qenë interaktive ka qenë bisedat rreth luftës edhe  
15 të zhvillimeve, rreth të ardhmes tonë normal. Kemi fol  
16 gjithçka që unë tash nuk më kujtohen në detaje.

17 PY. Çfarë lloj çështjesh, problemesh ke pasur dëshirë t'i  
18 ngrije me ta për t'i diskutuar?

19 PË. Për mbarëvajtjen e luftës, që lidhen me luftën me  
20 organizimin. I kam njoftue që unë kam pasë organizime të  
21 veçanta, për shembull, kam bë shtrirjen përmes subjekteve  
22 politike të gjitha kanë ndihmue. Ka qenë një organizim paksa  
23 më i veçantë meqenëse isha afër Prishtinës. Më këshillonte me  
24 këshilltarët e tij Adem Demaçi sepse ishim afër Prishtinës,  
25 domethënë, kishim veçanti tona në bazë të ambientit që ne e



1 jetonim.

2 PY. Çështjet organizative që ngritët, që donit apo që i  
3 ngritët, përfshinin edhe përfaqësimin e zonave në Shtabin e  
4 Përgjithshëm?

5 PË. Ka mund të jetë edhe kjo temë. Tash nuk po mundem me  
6 kuptu, me kujtue me saktësi.

7 PY. A përfshiu dhe bërjen publike të përbërjes së Shtabit të  
8 Përgjithshëm, pra, të anëtarëve?

9 PË. Nuk jam i sigurtë tani, Prokurore.

10 PY. Apo rregullimet financiare, problemet financiare a ishte  
11 kjo një problem, një çështje me interes?

12 PË. këto që po i përmendni kanë qenë probleme të përhershme  
13 dhe ne sa herë që kemi pasë rastin kemi fol për to. Kemi fol  
14 për logjistikën, për të mirat e luftës në përgjithësi, por në  
15 veçanti për atë takim mu nuk më kujtohet asnjë gjë çka kemi  
16 fol.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua të që të paraqesim në ekran  
18 një dokument me numër P00181 dhe anglishtja ka të njëjtin  
19 numër por në fund ka ET. Ju lutem të kalojmë në faqen  
20 SPOE0022666.

21 PY. Z. Mustafa, a shihni në krye të faqes ka një datë 27  
22 tetor 1998, thuhet:

23 "Takim me shtabin e zonës operative të Llapit".

24 E shikoni?

25 PË. Po, e shoh.

1 PY. Dhe pastaj është emri juaj dhe disa çështje apo probleme  
2 që keni ngritur që kishin nevojë për t'u diskutuar.

3 A janë këto llojet e problemeve që ju do të diskutonit në  
4 secilën prej këtyre takimeve, kështu?

5 PË. Unë nuk kisha dashtë të komentoj një pamflet të shkruar  
6 pak kjartë dhe nuk dihet nga ku vjen. Megjithëqë, s'po shoh  
7 gjë të keqe në të, por nuk dua të komentoj dokumentet e huaja

8 PY. E kuptoj. Pra, duke filluar me disa nga anëtarët e  
9 delegacionit.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin.

11 PY. Çfarë pozite kishte Hashim Thaçi në Shtabin e  
12 Përgjithshëm në aso kohe?

13 PË. Nuk jam i sigurtë që e kam ditë unë pozitën e Hashim  
14 Thaçit në këtë kohë, por Hashim Thaçi ka bërë publikisht shumë  
15 detyra në luftë dhe pas lufte dhe mue tash mund të bie në  
16 lajthitje, por unë Hashim Thaçin e kam njoh si ushtar të  
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i rëndësishëm për luftën tonë  
18 për liri. Po në kohën që po flasim, ishte tetor, nuk besoj që  
19 e kam ditë pozicionin e tij.

20 PY. Mendoje që ishte një person me rëndësi në UÇK?

21 PË. Ashtu. Njerëzit të cilët vizitoheshin secili, me secilin  
22 edhe për vete e mendoj ashtu, ne e dinim që janë njerëz të  
23 rëndësishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe flisnim me  
24 ta. Me askën që nuk mendoj që ka ardhë nga Drenica, nga  
25 Dukagjini, nga Shala nuk ka mund të flet me mue nëse s'ka qenë

1 i rëndësishëm. Nga kjo që po shpjegoj tani, kam pasë mendim që  
2 është i rëndësishëm. Ai ka ardhë në ekip me shefin e Shtabit  
3 të Përgjithshëm dhe ka qenë i rëndësishëm.

4 PY. A kishte ndonjë gjë tjetër që të krijoi përshtypjen se  
5 ishte i rëndësishëm?

6 PË. Nuk më kujtohet në detaje.

7 PY. Po anëtarët e tjerë të delegacionit si e trajtonin apo si  
8 reagonin ndaj tij?

9 PË. Nuk kam pasë, atëherë në atë kohë nuk kam vërejtë diçka.  
10 Ende nuk ishte koha kur ne mund të bënim pyetje për  
11 personalitetin e njerëzve.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshiroj që  
13 t'i tregoj dëshmitarit një deklaratë të mëparshme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është Pjesa 5, faqe 12 që vazhdon  
16 deri në 13 në anglisht. Dhe Pjesa 5, faqet 13 që vazhdojnë te  
17 faqja 14 në shqip.

18 PY. Për të dhënë një ide të përgjithshme, do të filloj të  
19 lexoj pak më herët në transkript, që përputhet plotësisht me  
20 atë që keni thënë në dëshminë tuaj, pastaj do të vemi te pika  
21 përkatëse për të cilën dua t'ju pyes. Ju keni thënë:

22 "PË. Ishte koha kur Hashim Thaçi fillon të dalë si një  
23 figurë shumë e rëndësishme në UÇK. Por për ne, personat e  
24 njohur këtu dhe në atë hierarki ishin Jakup Krasniqi dhe  
25 Bislum Zyrapit.

1 "PY. A e keni ditur në atë kohë që kanë ardhur për  
2 vizitë në fund të tetorit se çfarë pozita kishte Hashim Thaçi,  
3 pra, çfarë pozite kishte sipas mendjes suaj?

4 "PË. Unë e di që ty po të intereson kjo punë, por unë  
5 besoj që ai s'e ka ditë as vetë në atë kohë. Unë e di që ka  
6 qenë i rëndësishëm. Nga perspektiva e pasluftës e di që di dhe  
7 më shumë, por në atë kohë ju siguroj që s'e kam ditë. Unë e  
8 kam ditë që këta po e respektojnë dhe tash e kam respektu dhe  
9 unë.

10 "PY. Kur mendon që "këta i tregonin respekt" ishin këta  
11 tre të tjerët që ishin në delegacion me të?

12 "PË. Në sajë të qësaj e respektoj edhe unë.

13 "PY. Në rregull. Pra, Jakup Krasniqi, Bislam Zyrapi dhe  
14 Ramë Buja, që të jemi të qartë, e kanë trajtuar Hashim Thaçin  
15 me respekt?

16 "PË. Po. Që thotë këta të tre. Po këtë po them. Mund të  
17 them se në atë kohë mendohej se ishte ai që i shkruante  
18 komunikatat. Por më vonë, kur e di, tani ndërron precesioni.  
19 Në atë kohë kam mendu se është djalë i mençur dhe i shkruan  
20 komunikatat. Edhe vetë ai s'ka dashë me u paraqit në atë kohë  
21 i rëndësishëm".

22 Anëtarët e tjerë të delegacionit e respektonin, e  
23 trajtonin me respekt Hashim Thaçin?

24 PË. Në e kam thënë atëherë që, po. Po e them edhe sot.

25 PY. Jakup Krasniqi, çfarë roli kishte në Shtabin e

1 Përgjithshëm?

2 PË. Ka qenë zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

3 PY. Ka pasë një kohë ku ka pasur dhe një rol tjetër të dytë?

4 PË. E di kam pa dokumentet që ka shkru zëvendës. Po Jakup  
5 Krasniqin ne e kemi njohur të gjithë si zëdhënës të Ushtrisë  
6 Çlirimtare të Kosovës. E di që kanë dalë edhe evidenca që ka  
7 qenë zëvendës.

8 Dhe kjo për z. Thaçi që kam thënë shkruan komunikata,  
9 domethënë, komunikon me publikun këtë e kam pasë në mendje. Më  
10 vjen që, me atë kam mendue, njeri që merret me komunikim, me  
11 media.

12 PY. Kur thoni zëvendës e keni fjalën zëvendëskomandant i të  
13 gjithë UÇK-së?

14 PË. Ashtu kam pa disa evidenca, kam lexuar nga këto burimet e  
15 pasluftës, gjyqet e gjërat si këto. Por, unë po ju them në atë  
16 kohë Jakup Krasniqin e kam njoh si zëdhënës të Ushtrisë  
17 Çlirimtare të Kosovës. Si njeri të rëndësishëm, e kam  
18 respektue dhe e respektoj ende.

19 PY. Po Rexhep Selimi edhe ai ishte një anëtar tjetër i  
20 delegacionit, jo në këtë rast, por çfarë pozite ka pasur në  
21 Shtabin e Përgjithshëm?

22 PË. Ka qenë inspektor në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe  
23 anëtar shtabi.

24 PY. Pra, doni të thoni inspektor i përgjithshëm?

25 PË. Po, inspektor i përgjithshëm i shtabit në Ushtrinë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 22

1 Çlirimtare të Kosovës.

2 PY. Edhe anëtar i komandës së zonës -- ju kërkoj ndjesë, e  
3 kisha fjalën për Shtabin e Përgjithshëm. Pra, ka qenë anëtar i  
4 Shtabit të Përgjithshëm, thatë apo jo?

5 PË. Po, besoj që po.

6 PY. Mendoje aso kohe se ishte një figurë e rëndësishme në  
7 UÇK?

8 PË. Po. Rexhep Selimi gjithherë prej kohës që e kam takue e  
9 kam respektu dhe e kam njohë si luftëtar të zotin dhe njeri të  
10 rëndësishëm në organizimin e luftës. Ka qenë këmbëngulës të  
11 bëhet organizimi sa më i mirë i UÇK-së, sikur që ishim edhe ne  
12 vetë.

13 PY. Po Kadri Veseli çfarë roli ka pasur në Shtabin e  
14 Përgjithshëm?

15 PË. E kam respektue dhe e kam njohë. E kam ditë se është në  
16 Shtabin e Përgjithshëm, po e njoh shumë më pak se të tjerët që  
17 folëm. Nuk jam i sigurtë që e kam ditë pozicionin e tij të  
18 saktë gjatë luftës. Unë mbas lufte, shumë me të folme që janë  
19 bë mbas lufte, mund me ndiku dhe unë munda me pasë, munda me  
20 mendue se edhe atëherë e kam ditë. S'kemi fol asnjëherë për  
21 pozicion të tij dhe me të diçka.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Lawson,  
23 ka një problem teknik. Duhet të bëjmë një pushim prej disa  
24 minutash derisa të zgjidhet. Kështu që e ndërpresim punën  
25 mbase për pesë apo 15 minuta.

1 Mund ta nxirrni dëshmitarin nga salla.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
4 çaktivizuar]

5 --- Pauza fillon në orën 09.56

6 --- Seanca rifillon në orën 10.05

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na thanë që  
8 po funksionon çdo gjë siç duhet tani. Ishte diçka teknike. Sa  
9 i takon teknologjisë ka shumë pajisje këtu që prodhojnë shumë  
10 nxehtësi dhe u bë shumë vapë dje, sidomos për ne. Kështu që në  
11 qoftë se ju ndodh edhe ju që të keni shumë vapë, na thoni se  
12 është e rëndësishme që të jemi të gjithë komod në këtë  
13 ambient.

14 Atëherë mund të sillni dëshmitarin, Sekretare.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
17 çaktivizuar]

18 Znj. Lawson, vazhdoni.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

20 PY. Ju vetë a keni qenë në ndonjë moment anëtar i Shtabit të  
21 Përgjithshëm, z. Mustafa?

22 PË. Po, znj. Prokurore, më kanë thënë se jam. Për një kohë.

23 PY. Kur ka ndodhur kjo?

24 PË. Mundet me kanë shkurti.

25 PY. Pak a shumë për sa kohë keni qenë anëtar i Shtabit të

1 Përgjithshëm?

2 PË. Ndoshta për dy javë jam kthyer në regjionin tim, në zonën  
3 time.

4 PY. Kush ju tha se ishit anëtar i Shtabi i Përgjithshëm?

5 PË. Jam i sigurtë që Bislime Zyrapi e ka ditë, por kanë mujt  
6 me ditë edhe ata që ishin të përhershëm aty. Kur e kam lirue  
7 detyrën, unë nuk mbaj mend që i kam tregue dikuj. Nëse i kam  
8 tregue dikuj ka qenë Bislime Zyrapi. Jam lirue me  
9 vetiniciativë.

10 PY. A ju caktoi dikush apo ju tha dikush që të shkonit t'i  
11 bashkëngjiteshit Shtabit të Përgjithshëm?

12 PË. Po, po shefi i shtabit.

13 PY. Bislime Zyrapi?

14 PË. Po, mendoj që po.

15 PY. A mund të ketë qenë ndonjë person tjetër apo besoni që ka  
16 qenë Bislime Zyrapi?

17 PË. Ka mund me qenë dhe Jakup Krasniqi, po nuk besoj që ka  
18 qenë dikush tjetër që ma ka komunikue.

19 PY. Nuk mendoni se mund të ketë qenë ndonjë person i tretë,  
20 mendoni se një nga këta dy, kështu?

21 PË. Tash për tash nuk po më vjen në mendje dikush i treti që  
22 ka mundur të më thënë.

23 PY. A ju dhanë ndonjë detyrë konkrete, specifike?

24 PË. Po. Më ngarkuan me logjistikën e vendit.

25 PY. Çfarë detyrash mbulonte logjistika, pra, me çfarë



1 aspektesh merreshit?

2 PË. Të gjitha gjërat që është dashtë t'i kenë ushtari dhe  
3 njësitë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Unë në atë kohë më  
4 shumë e kam mendue në vijat e armatimit, armatosjen e Ushtrisë  
5 Çlirimtare të Kosovës me logjistikë. A prioritet për mua ishte  
6 kjo.

7 PY. Nga vinin këto armë, burimi kush ishte?

8 PË. Nga ku mundeshin.

9 PY. A mund të na jepni ndonjë vend konkret nga morët armë?

10 PË. Në zonën time kam marrë edhe nga Serbia. Shqipëria ka  
11 qenë burim ku kemi mujt me marrë, po kanë qenë edhe vende  
12 tjera aty ku kemi mundur. Po nuk ka qenë me shumicë, kanë qenë  
13 ato çka mundnin të sillnin me krahë.

14 PY. Bosnja ka qenë ndonjë nga vendet?

15 PË. Po, ka pasë edhe nga Bosnja ka kanë ardhë.

16 PY. Cilat ishin linjat e furnizimit të armëve në Kosovë,  
17 drejt Kosovës?

18 PË. S'ka pasë linja të rregullta, po kanë qenë ata aty ku  
19 mundnim aty i merrnim. Si ma të rregullt ne kemi llogaritur  
20 Shqipërinë me siguri, si mundësi më reale e jona ishte  
21 Shqipëria. Për mua si komandant zone kur isha në kufi me  
22 Serbinë ka qenë edhe përmes rrugëve të biznesit me Serbinë.

23 PY. Kush ishte Plaku?

24 PË. E di për kën mendohet, por unë nuk e kam njoftë.

25 PY. Ku qëndronte?

1 PË. Nëse është ky për çka po mendon, se ka pasur dhe një  
2 Plaku atje, unë e kam njohur një Plaku, një me pseudonim Plaku  
3 që ka qëndru në Shqipëri. S'e kam njohur por e kam ditë, e kam  
4 pasë të njohur që një person me emrin plaku gjindet në  
5 Shqipëri.

6 PY. A e ke idenë se çfarë detyrash mbulonte ose cilat aspekte  
7 mbulonte?

8 PË. Mundësia e grumbullimit të mirave materiale për luftë.

9 PY. Kush e financonte UÇK-në, nga vinte ky financim?

10 PË. Kushdo që mundej ka qenë një fond i luftës 3 përqindësh.  
11 Unë në regjionin tim kryesisht jam financuar nga njerëzit,  
12 ndoshta ishte përparësi që kisha kryeqendrën me vete dhe shumë  
13 njerëz ndërmarrës të Prishtinës kanë financuar drejtpërdrejt  
14 luftën.

15 PY. A kishte dhe nga jashtë vendit, mblidheshin dhe nga  
16 jashtë vendit?

17 PË. Po. Nga kudo që ka pasë shqiptarë, janë munduar të bëjnë  
18 organizim edhe të ndihmojnë luftën.

19 PY. Kush ishte Ali Ajeti?

20 PË. Ali Ajeti është dëshmor i luftës. Është vrarë në vitin  
21 1989. Njihni ndonjë person tjetër me këtë emër?

22 PË. Jo.

23 PY. A ju kujtohen kur kanë ndodhur negociatat e Rambujesë,  
24 kur kanë ndodhur?

25 PË. Ka ndodhë gjatë shkurtit edhe marsit. Ndoshta dhe

1 janarit. Nuk jam i sigurtë.

2 PY. 1999, kështu?

3 PË. Është proces që ka fillue më herët, por rreth 1999 po  
4 edhe në 1998 ka mujt me u fol për këto negociata, për fillim  
5 të negociatave.

6 PY. Pati takime të brendshme në UÇK mes anëtarëve të Shtabit  
7 të Përgjithshëm dhe komandantëve të zonave para kësaj periudhe  
8 dhe rreth kësaj periudhe kohore?

9 PË. Po.

10 PY. A ishin të shpeshta aso kohe?

11 PË. Nuk kanë qenë të shpeshta, po jemi taku dhe këtu njihemi  
12 më mirë me [e pakuptueshme] më parë më pyetnit, me z. Hashim  
13 Thaçi dhe të tjerët këtu njihemi më mirë.

14 PY. Ju ishit në favor të faktit që UÇK-ja të dërgonte një  
15 delegacion në Rambuje?

16 PË. Po, ishim të gjithë.

17 PY. Ju ishit në favor, ishit pro?

18 PË. Po kam qenë pro të shkohet në Rambuje, megjithëqë unë kam  
19 pasë favoritin tim Adem Demaçin për të shkuar atje, ai nuk ka  
20 pranë të shkojë.

21 PY. A ka pasur takim me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm  
22 përpara se të refuzonte pjesëmarrjen?

23 PË. Adem Demaçi, besoj.

24 PY. Po.

25 PË. Po.

1 PY. Anëtarët e delegacionit më pas erdhën të konsultoheshin  
2 me funksionarët e lartë të UÇK-së, përfshirë edhe ju, sa u  
3 takon kushteve të marrëveshjes?

4 PË. Po, hera kur kanë janë kthyer prej Rambujesë edhe unë  
5 isha pjesëmarrës.

6 PY. Kur erdhi puna për nënshkrimin e marrëveshjes, ju çfarë  
7 pikëpamje patët?

8 PË. Unë kam qenë kundër para se të ktheheshin të plotë që  
9 flisnin me ne.

10 PY. Dhe pasi folët me ta?

11 PË. Unë kam fol në telefonata me ta dhe ju kam lut të mos e  
12 nënshkruajnë marrëveshjen. Kurse pas ardhjes së tyre kanë  
13 sqaruar mirë dhe jemi kuptue që duhet të shkohet përsëri në  
14 Rambuje për të përfunduar negociatat dhe për të nënshkruar.

15 PY. Po në fund e pranuat kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Çfarë ju shtyu të vendosnit që të mos e prishnit këtë  
18 marrëveshje duket qenë kundër?

19 PË. Kanë folë me mua të gjithë miqtë e mi. Ka pasur dhe  
20 faktorë të tjerë nga jashtë që më kanë bind. Gjithashtu, edhe  
21 z. Adem Demaçi ka thënë se duhet të vazhdohet rruga dhe duhet  
22 të nënshkruhet kjo marrëveshje, edhe pse ai ka qenë kundër.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Doja të tregoja një dokument.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është SPOE00228796. Anglishtja po

1 ashtu po me ET në fund. A mund të shkojmë pak më poshtë tek  
2 shqipja?

3 PY. Njihni ndonjë nga nënshkrimet në këtë dokument?

4 PË. Unë e shoh që përngjan me nënshkrimin tim.

5 PY. Dhe nëse shohim tek shqipja në të majtë e shihni mirë  
6 gjurmë vule mund të themi që ka ngelur?

7 PË. Po.

8 PY. Teksti te paragrafi para nënshkrimeve thotë:

9 "Në përfundim, pas vlerësimit për dokumentin  
10 përfundimtar, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së do të japë  
11 mendimin përfundimtar lidhur me dokumentin pasi të konsultohet  
12 me komandantë të zonave operative. Shtabi i Përgjithshëm është  
13 në favor t'i thotë "po" kësaj marrëveshjeje. Kjo bazohet në  
14 opinionet pozitive që ka ushtria, forumet e ndryshme  
15 shtetërore shqiptare, mendimi i personaliteteve shqiptare dhe  
16 autoritet në fushën sociale dhe politike, si dhe ndikimi nga  
17 mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë".

18 A ju kujtohet kujt i referohet, për çfarë ishte ky  
19 dokument?

20 PË. Nuk e njoh dokumentin dhe s'po më kujtohet, znj.

21 Prokurore. Unë e di nëse kanë nënshkru këta njerëz që i shoh  
22 këtu, kam nënshkru edhe unë sigurt. Por nuk më kujtohet asgjë  
23 rreth këtij dokumenti.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva.

25 U çova në këmbë sepse leximi i rreshtit të fundit të këtij

1 teksti, dalin nja shfaqje të ndryshme, domethënë, transkripti  
2 nuk i përkon në nja dy fjalë fjalitë që u lexuan. Mund të jetë  
3 i rëndësishëm. Është bazuar në gjëra të ndryshme si dhe  
4 "mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë me influencë".

5 Jo, domethënë, nuk është "influencë" po me influencë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Doni ta lexoj dhe njëherë fjalinë  
8 apo është e qartë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Ka pasur një -- me sa di ka pasur  
10 një përkthim tjetër të këtij materiali dhe më duket se nuk  
11 është njësoj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë kush  
13 është dokumenti përfundimtar.

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është version i rishikuar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju po  
16 lexoni versionin e rishikuar?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në fakt duhet të kisha kërkuar  
18 versionin e rishikuar.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë le të  
20 nxjerrim versionin e rishikuar.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Është i njëjti numër po thjesht  
22 në fund lexon *Revised*.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndryshim  
24 me atë që sapo lexuat ju?

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në fakt jo, është njësoj siç e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 31

1 lexova.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë tërheq komentin tim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
4 që e vutë në dukje sidoqoftë.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do kërkoja që  
6 të pranohet ky dokument si provë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka asnjë  
9 kundërshtim, materiali SPOE00228796-ET i Rishikuar dhe  
10 përkthimi në shqip pranohen. Ju lutem t'i vendosni numrin e  
11 provës materiale.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e  
13 provës materiale P227.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
15 Mund të vazhdoni, znj. Lawson.

16 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

17 PY. Pak a shumë në periudhën e negociatave të Rambujesë  
18 kishte diskutime të brendshme sa i takon përbërjes së Shtabit  
19 të Përgjithshëm?

20 PË. Po, kemi fol për gjithçka për organizim ma të mirë dhe  
21 për mundësi më të mira të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

22 PY. Komandanti i ri i përgjithshëm, në fakt, mos u emërua në  
23 atë kohë?

24 PË. Po më kujtohet se është emëruar, për mua, ishte  
25 komandanti i parë në atë kohë. Unë nuk jam kanë, nuk kam pasë

1 njohur që ka pasë komandant më herët.

2 PY. Kush u emërua?

3 PË. Është emëruar Sylejman Selimi.

4 PY. U propozuan kandidatë të tjerë për këtë pozitë?

5 PË. Nuk më kujtohet që është propozuar dikush.

6 PY. A u morr parasysh dhe mundësia për Bislim Zyrabin, u  
7 konsiderua?

8 PË. Po tash më kujtohet se edhe Bislim Zyrabi është pa si  
9 mundësi.

10 PY. Kush ka qenë i pranishëm në takimin ku u bë emërimi i  
11 Sulejman Selimit?

12 PË. Kanë qenë komandantët e zonave.

13 PY. A kishte dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të  
14 pranishëm?

15 PË. S'po më kujtohet. E di që ka qenë një keqkuptim, po më  
16 duket ka qenë një anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, Sokol  
17 Bashota, por pastaj e ka lëshue mbledhjen, e ka lëshue  
18 takimin.

19 PY. Rexhep Selimi ishte i pranishëm?

20 PË. Po, ka mund të jetë edhe Rexhep Selimi.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të bëjmë një pushim të  
22 shkurtër, ju lutem? Pesë minuta? Vetëm Pesë minuta pushim, me  
23 lejen e Trupit Gjykues.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
25 çaktivizuar].



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje nga znj. Lawson (Vazhdim)

Faqe 33

1 Pesë minuta pushim.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 --- Pauza fillon në orën 10.29

4 --- Seanca rifillon në orën 10.35

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Silleni

6 dëshmitarin.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Trupit Gjykses për  
8 këtë ndërprerje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na njoftoni  
10 nëse keni nevojë për ndonjë pushim tjetër mund ta bëjmë  
11 përsëri.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju  
14 lutem.

15 Përkthyesit kërkojnë, Dëshmitar, që kur të flisni të  
16 rrini më pranë mikrofonit me qëllim që të dëgjojnë më mirë.

17 Znj. Lawson, mund të vazhdoni, jemi gati.

18 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

19 PY. Pra, z. Mustafa, po diskutonim ndryshimin e komandantit  
20 të përgjithshëm të UÇK-së. Pse u bë ky ndryshim?

21 PË. Për neve nuk ishte ndryshim. Për mua personalisht ka qenë  
22 emërim.

23 PY. Menduat se kjo gjë mund të ndikonte në delegacionin e  
24 Rambujesë?

25 PË. Edhe kjo ka qenë arsye shtesë. Donim të ndihmonim

1 delegacionin se ne nuk pranojmë marrëveshje të çfarëdo që  
2 afrohen, duhet të jenë marrëveshje që përputhen me interesat e  
3 kombit tonë.

4 PY. Pra, qëllimi ishte për t'i dhënë një mbështetje të  
5 mëtejshme negociatave, kështu?

6 PË. Ishte dhe kjo pjesë e qëllimit tonë, por dhe duhej dhe  
7 dëshironim të kishim komandantin, ta dinim se kë kishim  
8 komandant.

9 PY. Tani do të ndryshojmë temën. Një nga qëllimet e sektorit  
10 të zbulimit apo inteligjencës ishte për të mbledhur  
11 informacion për bashkëpunëtorët?

12 PË. Ka mujt me qenë edhe ajo një nga objektivat.

13 PY. Ishte zbulimi i aktiviteteve propagandistike,  
14 psikologjike, një nga detyrat e sektorit të inteligjencës?

15 PË. Prej kësaj perspektivë unë mund të flas për inteligjencën  
16 më shumë. Në atë kohë nuk e kam kuptue kështu si po mundem me  
17 e sqaru tash.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të na sqaroni pak çfarë  
19 keni parasysh me termin e inteligjencës, "sektori i  
20 inteligjencës" është fjala për zonën e Llapit edhe për çfarë  
21 periudhe kohe? Pra, nëse shumicën e kohës duhet bërë pyetja  
22 dhe në relatë me kohën.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E kam fjalën për sektorin e  
24 inteligjencës në zonën e Llapit me të cilin mendoj që  
25 dëshmitari është i njohur dhe nga mënyra e funksionimit të

1 tij.

2 PY. Pra, përgjigja që dhatë z. Mustafa u mbështet në këtë  
3 ide, pra, ju e keni ditur këtë gjë?

4 PË. Po, unë e kam ditë se secila njësi ka pasë një person që  
5 është kujdesur për rreziqet e mundshme të njësisë, gjithashtu  
6 edhe të zonës.

7 PY. Një nga detyrat e sektorit të moralit a ishte që t'i  
8 kushtonte vëmendje fushatës së përgjithshme të luftës?

9 PË. Sektori i moralit po mendon?

10 PË. Po sektori i moralit.

11 PË. Nuk më kujtohen detyrat, po të gjitha sektorët e Ushtrisë  
12 Çlirimtare të Kosovës kanë të bëjnë me fuqizimin,  
13 propagandimin dhe mundësive më të mira për luftën që po  
14 zhvillonim.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju lutem të paraqesim një  
16 dokument P00149. Në anglisht është i njëjti numër po në fund  
17 ka ET.

18 PY. E pamë këtë dokument ditën e parë që ishit këtu z.  
19 Mustafa. Është rregullorja e zonës operative të Llapit që e  
20 keni lëshuar në dhjetor të 1998.

21 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 3. Që ka  
22 numrin 242140 në shqip dhe mendoj që është faqja 3 në  
23 anglisht.

24 PY. Të shohim tek paragrafi i pestë nga fundi, thotë:

25 "Një nga detyrat e sektorit të moralit ishte të përcjellë

1 në bashkëpunim me sektorin e inteligjencës mënyrat, mjetet e  
2 veprimit të armikut në planin propagandistik dhe subversiv  
3 psikologjik".

4 E shikoni?

5 PË. Po është përcjellë dhe një pjesë e literaturave të kohës.  
6 Nuk e njoh burimin nga ka ardhë, por e pranoj si të tillë  
7 dokumentin.

8 PY. I referohet propagandës, përhapja e propagandës në lidhje  
9 me UÇK-në konsiderohej si një formë e veçantë e luftës?

10 PË. Formë e veçantë nuk e di, por ka patur dhe propagandën  
11 lufta.

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të kthehem një faqe më pas.  
13 Faqja 2 në anglisht dhe 2139 në shqip.

14 PY. Aty ku është titulli "Në sektorin e inteligjencës"  
15 shikojmë pikën e katërt, siç e konfirmuat dhe ju, një nga  
16 detyrat ishte të veprimtaritë të zbulonin "Veprimtaritë  
17 propagandistike dhe psikologjike të armikut".

18 Pra, ishte lufta e posaçme një problem për UÇK-në?

19 PË. Znj. Kryetare, ne e kemi vu në letër në bazë të  
20 literaturave që kemi gjetë dhe kemi vendosë detyra, mirëpo në  
21 përgjithësi detyrat e këtij sektori kanë qenë mbledhja,  
22 grumbullimi dhe kujdesja për njësitet që i ka përfaqësue.

23 PY. Lufta e veçantë e posaçme ishte një problem për UÇK-në?

24 PË. Të gjitha këto që i kemi pa, ne i kemi pasë si problem se  
25 përndryshe nuk ishin vu në letër. Mirëpo, nuk besoj se kemi

1 pasë kapacitete dhe mundësi për me e arrit. Ne s'kemi pasë as  
2 mjete, as mundësi me e zhvillu punën deri aty.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument për  
4 momentin.

5 PY. E diskutoi Shtabi i Përgjithshëm këtë çështjen e luftës  
6 së posaçme speciale thotë kjo në deklarata publike apo në  
7 takime?

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara se dëshmitari t'i  
9 përgjigjet, është e qartë se Prokurorja po pyet për luftën e  
10 posaçme, po pa një shpjegim se çdo të thotë kjo. Pra, ju lutem  
11 koleges të shpjegojë për çfarë po e pyet dëshmitarin  
12 konkretisht dhe çfarë ka parasysh me këtë "luftën speciale, të  
13 posaçme", në pyetjet që bën.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të na  
15 ndihmonte të gjithëve. Nuk ka dalë në pyetje deri tani. Mbase  
16 është një pyetje themelore domethënë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

18 PY. Çfarë kuptoni ju me termin "luftë speciale, e posaçme" të  
19 themi?

20 PË. Tash nuk kam në mendje asgjë. Mvaret konteksti për ku e  
21 përdorim.

22 PY. E njihni këtë term?

23 PË. Znj. Kryetare, unë tash e njoh, është tjetër, por në  
24 kohën kur i kam pasë 26 vite kur isha komandant zone është ka  
25 qenë ambient tjetër dhe njohjet e mia kanë qenë më të

1 kufizuar. Por literaturë kemi pasë dhe e kemi sistemuar nëpër  
2 dokumenta tonë. Kjo nuk do të thotë se të gjitha ato i kemi  
3 ditun dhe ia kemi arrit synimeve tona të gjitha.

4 PY. E ka përdorur këtë term Shtabi i Përgjithshëm "luftë e  
5 veçantë speciale", thotë fjalë për fjalë në deklaratë apo në  
6 takime?

7 PË. Nuk më kujtohet. Unë nuk besoj që është përdorë. Nëse  
8 është përdorë është përdorë sikur ky dokumenti që e pamë në  
9 zonën time ka mund të jetë literaturë, por në Shtab të  
10 Përgjithshëm nuk është fol për të. Mua nuk më kujtohet.

11 PY. A ju kanë dhënë paralajmërime njerëzve që merreshin me  
12 këtë luftën e veçantë speciale?

13 PË. Ne, në fakt, nuk e kemi ditë as kush janë ata.

14 PY. Për kë e keni fjalën kur nuk e dinim kush ishin "ata"?

15 PË. Që po bënë luftë speciale. Ne i luftonim kundër forcave  
16 armike dhe brenda forcave armike ka pasë të gjitha njësitet që  
